



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Fakulteti i Edukimit**

**Programi i studimit:  
Pedagogji –Drejtimi: Teorik-Shkencor**

*Niveli i studimeve:*

Master

*Numri i kredive:*

120 ECTS

*Akredituar për periudhën:*

1 Tetor 2014- 30 Shtator 2017

*Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financiar nga Bashkimi Europian.*

*The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.*

## **PËRMBAJTJA:**

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	4
2. REZULTATET E PRITURA: .....	5
3. PROGRAMI STUDIMOR: Pedagogji –Drejtimi: Teorik-shkencor.....	6
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS .....	8

## **1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Qëllimi i programit Master në pedagogji, Drejtimi Teorik-Shkencor është: Përgatitja e studentëve për të reflektuar në mënyrë kritike për problemet pedagogjike, sociale e kulturore, të zbatojnë në mënyrë kualitative arritjet bashkëkohore në institucionet edukativo-arsimore e socio-kulturore dhe të zhvillojnë hulumtime shkencore, për të avancuar praktikat aktuale pedagogjike, kulturore e shoqërore.

## **2. REZULTATET E PRITURA:**

Me përfundimin e suksesshëm të programit të studimeve, studentët do të jenë në gjendje:

- Të kryejnë punë të specialistit profesional në institucionet edukative-arsimore;
- Të avancojnë praktikat ekzistuese në institucionet arsimore e socio-kulturore;
- Të zhvillojnë hulumtime kërkimore profesionale;
- Të vlerësojnë praktikat pedagogjike, sociale, kulturore e rekreative ekzistuese;
- Të rekomandojnë dhe implementojnë qasje efektive pedagogjike, dhe të kontribuojnë në popullarizimin dhe aktualizimin e çështjeve edukativo-arsimore;
- Të hartojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë projekte nga fusha pedagogjike;
- Të përparojnë praktikën edukativo-arsimore duke identifikuar problemet duke realizuar hulumtime dhe duke i përdorur gjetjet e hulumtimit.
- Të shqyrtojnë në mënyrë kritike përmbajtjen e teksteve mësimore dhe avancojnë atë;
- Të këshillojnë dhe ofrojnë ndihmë profesionale-pedagogjike për mësimdhënësit në përmirësimin e performancës dhe ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Të udhëzojnë studentët praktikantë dhe ndihmojnë mësimdhënësit fillestarë;
- Të iniciojnë dhe mbështesin programe trajnimi me bazë në shkollë;
- Të monitorojnë respektimin e të drejtave dhe përgjegjësisë të fëmijëve, mësimdhënësve dhe të prindërve.

### 3. PROGRAMI STUDIMOR: Pedagogji –Drejtimi: Teorik-shkencor

#### VITI I PARË SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Fushat e edukimit	O	3+1	7
2.	Filozofi e edukimit	O	3+2	6
3.	Qasje në pedagogji bashkëkohore	O	3+1	6
4.	Mësimnxënia dhe mësimdhënia efektive	O	3+2	6
5.	Metodologji e hulumtimit dhe zbatimi i SPSS-it në hulumtime pedagogjike	Z	1+2	5
6.	Gjuhë angleze	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+8</b>	<b>30</b>

#### SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Teknologjia në arsim	O	3+2	7
2.	Vlerësimi në mësimdhënie	O	3+1	6
3.	Metodat e hulumtimit kualitativ	O	3+2	7
4.	Vlerësimi dhe intervenimi për fëmijët me vështirësi në të nxënë	O	3+2	5
5.	Edukimi për karrierë	Z	2+1	5
6.	Hulumtimi në veprim	Z	2+1	5
7.	Andragogji e kohës së lirë	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>14+8</b>	<b>30</b>

## VITI I DYTË

### SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Arsimi i të rriturve	O	3+2	7
2.	Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv	O	3+1	6
3.	Edukimi në fëmijërinë e hershme	O	3+2	7
4.	Pedagogji e trajnimeve	O	3+2	5
5.	Preventiva dhe intervenimi në shkollë dhe familje	Z	2+1	5
6.	Edukimi për qytetari demokratike	Z	2+1	5
7.	Trajtimi pedagogjik i sjelljes së papërshtatshme në shkollë	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>14+8</b>	<b>30</b>

### SEMESTRI IV

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Punimi me shkrim dhe mbrojtja/prezantimi	O	3+2	
2.	Praktikë pedagogjike	O	3+1	10
3.	Teza e masterit	O	3+2	
4.	Hartimi i planit ideor të punimit master dhe planit detal	O	3+2	5
5.	Zgjedhja dhe përshtatja e instrumenteve për hulumtim	O	2+1	3
6.	Hartimi dhe mbrojtja e punimit master	O	2+1	12
<b>Gjithsej</b>				<b>30</b>

#### 4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p><b>Fushat e edukimit</b></p> <p>Kursi ngërthen fushat e edukimit, si të integruara dhe të veçanta, si: edukimin fizik, shëndetësor e seksual, edukimin intelektual, edukimin moral dhe social, edukimin human e demokratik, edukimin kombëtar e ndërkombëtar, edukimin e tolerancës, pastaj edukimin estetik dhe punues, edukimin për krijimtari.</p>
2	<p><b>Filozofi e edukimit</b></p> <p>Ky kurs do t'u ndihmojë studentëve që të kuptojnë nocionet themelore të edukatës, historinë e edukimit dhe të shkollës gjatë etapave të zhvillimit shoqëror, konceptionet e filozofëve dhe pedagogëve të mëdhenj si dhe me teoritë bashkëkohore të edukimit si: pragmatizmi, edukimi progresiv, kognivizmi, konstruktivizmi, humanizmi etj.</p>
3	<p><b>Qasje në pedagogji bashkëkohore</b></p> <p>T'u ofrohen studentëve master përmbajtje thelbësore për çështjet e përgjithshme të edukimit dhe të arsimimit, dhe për rëndësinë e tij, që ka për formimin e individit dhe të shoqërisë. Të zotërojnë dituri për ligjshmëritë e procesit të edukimit dhe të arsimit, për karakteristikat dhe veçoritë qenësore të tij. Të mësojnë, gjithashtu, për tiparet e sistemit arsimor demokratik, për edukimin demokratik, edukimin global, edukimin për paqe dhe tolerancë, për kulturën e demokracisë, edukimin për qytetari demokratike, për reformën e arsimit, synimet dhe objektivat e saj, për misionin dhe tiparet e arsimit të shkollës sonë sot, për rolin e shkollës në orientimin e të rinjve në profesione të dëshirueshme, për rolin e ndryshuar të arsimit dhe nxënësit, si rezultat i inkorporimit të strategjive të reja të mësimdhënies, të mësimnxënies dhe të vlerësimit.</p>
4	<p><b>Mësimnxënia dhe mësimdhënia efektive</b></p> <p>Kursi përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë trajton aspektet e të nxënës dhe pjesa e dytë (që për nga vëllimi është më e madhe) trajton aspektet e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, ofrohen njohuri të avancuara nga fusha e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Në kuadër të kësaj ofrohen tema, që trajtojnë çështjet e strategjive të të nxënës, stileve të të nxënës, parimeve të mësimdhënies efektive, mënyrave të aplikimit të metodave efektive të mësimdhënies, taktin pedagogjik, rëndësinë e përgatitjes së mësimdhënësit, karakteristikat e mësimdhënësit efektiv, etj. Kursi ofron mundësi të zhvillimit të shkathtësive, për zbatim të suksesshëm të parimeve e strategjive të mësimdhënies, identifikimin e sfidave të mësimdhënies dhe dhënies së sugjerimeve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
5	<p><b>Metodologji e hulumtimit dhe zbatimi i SPSS-it në hulumtime pedagogjike</b></p> <p>Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e hulumtimeve pedagogjike. Në kuadër të këtij kursi ofrohen përmbajtje për qasjen kuantitative të hulumtimit dhe metodat kuantitative të hulumtimit. Kursi ofron tema, përkitazi me metodat kuantitative të hulumtimit: metoda ekperimentale, metoda e vëzhgimit, intervista e strukturuar, etj.,</p>



	<p>procedurat, hapat e hulumtimit, analizat e të dhënave, etj. Të gjitha këto metoda ilustrohen me shembuj praktikë nga hulumtimet në institucionet arsimore. Përmes trajtimit të temave, zhvillohen shkathtësi të organizimit të hulumtimeve, përdorimit efikas të metodave kuantitative, analizës së të dhënave dhe shkathtësi të shkrimit akademik.</p>
6	<p><b>Gjuhë angleze</b></p> <p>Anglishtja për pedagogji është një aftësi bazë e projektuar posaçërisht për studentët e pedagogjisë, të cilët janë gati për të hyrë në Anglisht-Medium studime të nivelit terciar. Ajo siguron praktikë, që vlerësohet me kujdes dhe ecuri në aftësitë kryesore akademike, që të gjithë studentët kanë nevojë, të tilla si: duke dëgjuar ligjërata dhe duke folur në seminare. Kursi përmban tema të ndryshme nga jeta e përditshme, kultura dhe tekste autentike, të cilat kanë për qëllim ngritjen e nivelit të leximit, kuptimit dhe komunikimit gojor dhe me shkrim nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</p>
7	<p><b>Teknologjia në arsim</b></p> <p>Kursi, <i>Teknologjia në arsim</i>, ofrohet për të promovuar procesin e njohjes dhe zbatimit të teknologjisë arsimore në praktikën mësimore. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të teknologjisë së arsimit, duke filluar nga “abakusi” e deri te format modalitetet e avancuara të mësimin dhe të të nxënësve elektronik. Veçmas, do të trajtohet aktualiteti dhe zbatimi i teknologjisë arsimore, si elementi i katërt i pesëkëndëshit didaktik. Po ashtu, do të debatohet për sisteme “të hapura” dhe sisteme “të dedikuara” për fushën e veprimtarisë arsimore. Do të promovohet edhe puna praktike në zbatimin e teknologjisë ekzistuese në mësimdhënie, duke debatuar për përparësitë dhe kufizimet e saj dhe zhvillimin e mendimit kritik të edukuesve. Do të debatohet edhe për dimensionet polivalente të teknologjisë dhe perspektivën e saj në shoqërinë bashkëkohore.</p>
8	<p><b>Vlerësimi në mësimdhënie</b></p> <p>Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi të avancuara, përkitazi me konceptet e dokimologjisë didaktike. Ofrohen përmbajtje, të cilat trajtojnë çështjen e vlerësimit në shumë dimensione. Në kuadër të kursit trajtohen tema, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit në institucionet arsimore në përgjithësi, si dhe vlerësimit të diturive të nxënësve në veçanti. Trajtohen tema si: vlerësimi në institucionet arsimore, vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm, vlerësimi me bazë shkolle, llojet e vlerësimit të diturive të nxënësve: vlerësimi sumativ, vlerësimi formativ. Gjithashtu, analizohen dobësitë dhe përparësitë e llojeve të ndryshme të vlerësimit. Mësimdhënia bashkëkohore, krahas ndryshimit esencial të strategjive të mësimdhënies në raport me mësimdhënien tradicionale, kërkon edhe ndryshimin e procesit të vlerësimit të diturive të nxënësve. Në këtë mënyrë, në veçanti, do të trajtohen çështje, që kanë të bëjnë me vlerësimin formativ, vlerësimin e vazhdueshëm.</p>
9	<p><b>Metodat e hulumtimit kualitativ</b></p> <p>Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e hulumtimeve pedagogjike. Në kuadër të kursit ofrohen përmbajtje për qasjen kualitative të hulumtimit dhe metodat kualitative të hulumtimit. Kursi ofron tema, përkitazi me metodat kualitative të hulumtimit:</p>

metoda e fokus grupit, studim rasti, intervista e pastandardizuar, observimi, analiza e të dhënave sipas qasjes kualitative, etj. Të gjitha këto metoda ilustrohen me shembuj praktikë nga hulumtimet në fushën e edukimit, përkatësisht në institucionet arsimore. Gjithashtu, ofrohen edhe tema që sqarojnë qasjen mikste të hulumtimit. Përmes trajtimit të temave, zhvillohen shkathtësi të organizimit të hulumtimeve, përdorimit efikas të metodave kualitative, analizës së të dhënave dhe shkathtësi të shkrimit akademik.

10 Vlerësimi dhe intervenimi për fëmijët me vështirësi në të nxënë

Vështirësitë në të nxënë paraqesin një gjendje, e cila tashmë në përmasa të gjera është e njohur si gjendje, që çon drejt vështirësive serioze, jo vetëm në të nxënit e lëndëve gjatë moshës shkollore, por shpesh edhe në moshën e rritur. Fëmijët me vështirësi në të nxënë ndeshen me disa vështirësi jo të zakonshme, të cilat mund ta pengojnë të nxënit e leximit (njohjen, rrjedhshmërinë dhe të kuptuarit e fjalëve); shkrimit (dorëshkrimin, drejtshkrimin dhe krijimin e punimeve me shkrim); rikujtimit, arsytimit dhe organizimit të informatave, ose performimit në matematikë (kalkulimin dhe zgjidhjen e problemeve). Ky kurs është dizajnuar për të ofruar njohuri teorike për këto tema dhe shkathtësi praktike lidhur me identifikimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë, si dhe për t'u ndihmuar atyre në përmirësimin dhe përjetimin e suksesit, përmes zbatimit të metodave efektive të intervenimit. Edhe pse fëmijët dhe të rinjtë me vështirësi në të nxënë gjenden në çdo klasë, kjo gjendje shpesh neglizhohet në klasat e zakonshme, ashtu që nevojat arsimore të tyre nuk adresohen fare. E përshkruar si dobësi në mesin e anëve të forta, gjendja e vështirësive në të nxënë bëhet tejet komplekse, sepse çdo fëmijë posedon një kombinim unik të talentit dhe anëve të forta e të dobëta. Nëse këta fëmijë nuk identifikohen dhe nuk trajtohen, ata janë të destinuar të bëhen më shumë sesa një dështim arsimor (mendo këtu për mosvijimin dhe braktisjen e shkollës, punën e fëmijëve, delikuencën). Prandaj, identifikimi, si dhe trajtimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë, do të jenë preokupimet kryesore gjatë këtij kursi.

11 Edukimi për karrierë

Përmes këtij kursi, do t'u ofrohen studentëve MA përmbajtje, që kanë të bëjnë me rëndësinë që ka edukimi për karrierë për të rinjtë dhe të rriturit tanë sot. Studentët do të përvetësojnë, gjithashtu, informacione, që janë të dizajnuara për t'u ndihmuar të rinjve të zgjedhin rrugën e tyre arsimore, si dhe perspektivën e tyre në tregun e punës. Edukimi për karrierë, është pjesë përbërëse e orientimit të të rinjve në karrierë, i cili si përmbajtje nënkupton disa nga aktivitetet me rëndësi, për të cilat do të debatohet më gjerësisht, si p.sh.: fillet e orientimit dhe të edukimit për karrierë (profesion), përkufizimet, aktivitetet, organizatat, që ofrojnë shërbime për karrierë, pastaj personeli i orientimit në karrierë, fazat, faktorët, format e edukimit dhe të bashkëpunimit të shkollës me komunitetin për edukim dhe orientim në karrierë, etj. Rëndësi kanë edhe përfitimet, që u sjell të rinjve dhe shoqërisë në përgjithësi edukimi dhe orientimi për karrierë dhe në karrierë. Nga ky kurs të njihen, gjithashtu, për mangësitë që mund t'i sjellë, jo vetëm shoqërisë, po edhe individit, edukimi dhe orientimi i gabuar për karrierë dhe në karrierë, dështimi i të rinjve në profesion e punë, dhe sa mund të ndikojë shkolla, po edhe faktorët tjerë që ky problem të ngrihet në shkallë profesionale dhe institucionale.

12	<p><b>Hulumtimi në veprim</b></p> <p>Si një nga llojet e hulumtimeve në arsim, hulumtimi në veprim është një komponent i zhvillimit profesional dhe reflektim kritik i praktikës së tyre profesionale. Përmbajtja është e fokusuar në shpjegimin e nocioneve bazë të hulumtimit, si dhe hapat praktikë për realizimin e tij. Përmes kursit ofrohet mundësia e krijimit të shkathtësive hulumtuese të edukatorëve dhe shfrytëzimi i këtyre shkathtësive në përmirësimin e praktikave edukative.</p>
13	<p><b>Andragogji e kohës së lirë</b></p> <p>Kursi <i>Andragogji e kohës së lirë</i> ofrohet për të promovuar procesin e njohjes dhe zbatimit të kohës së lirë, si fenomen i shoqërisë bashkëkohore. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të dukurisë së kohës së lirë në kontekst të ndryshimeve shoqërore, duke e kundruar atë në zhvillimin e saj kontinual nga komuniteti i parë e deri në shoqërinë bashkëkohore. Veçmas, do të trajtohet dimension i poliedrik i saj, duke filluar nga dimension i filozofik, sociologjik, psikologjik, edukologjik dhe veçmas, trajtohet aspekti i konstituimit të disiplinës së pedagogjisë së kohës së lirë në kuadër të pedagogjisë si shkencë aplikative. Në kurs trajtohen gjithanshëm determinantët, që e kushtëzuan aktualizimin e trajtimit teorik e praktik të kohës së lirë, si dukuri në ekspansion dhe të pedagogjisë së kohës së lirë, si disiplinë pedagogjike. Në kurs do të trajtohen gjithanshëm edhe aktivitetet, me të cilat përbushet koha e lirë dhe veçmas, trajtohet vështirësia në klasifikimin e tyre, sepse tani nuk mund të flitet vetëm në kontekstin “bardh-zi”, përkatësisht vetëm për aspektin konstruktiv apo destruktiv të tyre, si dhe përqendrohet në vështirësitë, që e shoqërojnë procesin e klasifikimit. Kursi ofron përmbajtje edhe për funksionet e aktiviteteve të kohës së lirë (funksioni i zhvillimit, argëtimit e zbavitjes, si dhe funksioni i pushimit) si domosdoshmëri e kohës, në të cilën jetojmë. Në kurs do të përpunohen e diskutohen bashkërisht me studentë përmbajtje, që udhëzojnë shfrytëzimin kreativ dhe përmbajtjesor të kohës së lirë dhe veçmas theksohet aspekti “kurativ” i saj.</p>
14	<p><b>Arsimi i të rriturve</b></p> <p>Kursi <i>Arsimi i të rriturve</i> ofrohet për të promovuar punën me të rritur si popullacion specifik, nga puna me të cilin preferohen dituri, shprehi dhe shkathtësi të veçanta, për të arritur sukses në punë. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të arsimit të të rriturve në kontekst të nevojës për arsimim, ndryshim dhe perfeksionim të vazhdueshëm profesional. Kursi përmban qasjet më të reja, përkitazi me trajtimet teorike dhe praktike për ndryshimet në arsimin e të rriturve, procese, të cilat e shoqërojnë njeriun e rritur si qenie gjenerike, si dhe udhëzon për veçantitë e punës me të rritur. Në kurs trajtohen përmbajtje teorike, që ndërliken me fillet e para të veprimtarisë praktike e teorike të punës me të rritur. Kursi ofron përmbajtje për format elementare të bartjes së përvojave e deri te bartja strukturore dhe e organizuar e punës me të rritur, duke trajtuar edhe teorinë për mësimin dhe të nxënies të të rriturve (Inteligjenca, kujtesa, përvoja dhe mbamendja). Kursi ofron përmbajtje edhe për aspektet didaktike të punës me të rritur, si dhe promovon strategji bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies së të rriturve. Po ashtu, në kurs theksohet edhe</p>

	vetaktualizimi dhe vetrealizimi si qasje sublimë, që i ysht të rriturit në planin e ndryshimit të vazhdueshëm dhe të përshtatjes në epokën e globalizimit dhe të integritimeve si procese botërore, si dhe promovon filozofinë e vetarsimit dhe të arsimit gjatë gjithë jetës.
15	<p><b>Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv</b></p> <p>Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë kurs trajtohen tema që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të inkluzionit, të drejtat e njeriut/fëmijës, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vendet evropiane, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave të inkluzionit në vende të ndryshme të botës, duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Ofrohen edhe mundësi të vlerësimit të situatës në institucionet arsimore dhe me gjerë në Kosovë dhe formave të implementimit të edukimit inkluziv. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi të planifikimit të suksesshëm të punës në institucione të niveleve të ndryshme të arsimit dhe dhënies së rekomandimeve, të cilat promovojnë vlerat e inkluzionit.</p>
16	<p><b>Edukimi në fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Në këtë kurs trajtohet studimi i teorive psikologjike e pedagogjike, përkritazi me fëmijërinë e hershme dhe krahasimi i teorive të avancuara me ato të vjetruara; njohja më e thellë e proceseve psiko – pedagogjike e sociale, që zhvillohen në fëmijërinë e hershme; studimi teorik dhe hulumtimi empirik i zhvillimit të aspekteve të personalitetit, gjithnjë të analizuara në determinancë gjenetike, pedagogjike, sociale, kulturore dhe në cilësinë e aktivitetit personal.</p>
17	<p><b>Pedagogji e trajnimeve</b></p> <p>Duke pasur parasysh nevojën e zhvillimit profesional të vazhdueshëm të punonjësve të institucioneve arsimore dhe institucioneve të tjera shoqërore, janë të domosdoshme edhe njohuri e shkathtësi nga fusha e trajnimeve. Prandaj, përmes këtij kursi ofrohen njohuri të avancuara për trajnimet, përgatitjen, organizimin dhe realizimin e punëtorive. Në kuadër të kursit, në pjesën e parë, trajtohen tema, që kanë të bëjnë me dallimet midis të mësuarit të të rriturve dhe nxënësve të moshës shkollore, motivet dhe stilet e të mësuarit. Ndërsa, në pjesën e dytë, trajtohen tema, që kanë të bëjnë me përgatitjen e punëtorive (mjetet, kohën e menaxhimit, buxhetin, qëllimet, etj.), udhëheqjen e punëtorive (procesin, fascilitimin, outputet), përfundimin e punëtorive dhe aspekte të tjera teknike. Gjithashtu, ofrohen edhe tema, që kanë të bëjnë me cilësitë e trajnerit të suksesshëm. Përmes këtij kursi zhvillohen shkathtësi të komunikimit të mirë pedagogjik, shkathtësi të trajnerit të suksesshëm dhe aplikuesit të suksesshëm të strategjive ndërvepruese të mësimdhënies.</p>
18	<p><b>Preventiva dhe intervenimi në shkollë dhe familje</b></p> <p>Ky kurs është i dizajnuar, në mënyrë që studentët të njihen me teorinë dhe praktikën për preventivat dhe intervenimin e drejtë në familje dhe shkollë. Kursi bën identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shkollë–preventivat; strategjitë efektive për intervenim në shkollë e familje. Është me rëndësi kritike që studentët të zhvillojnë të kuptuarit dhe aftësitë për të punuar në të ardhmen edhe në</p>

	<p>fushën e intervenimit në familje e shkollë, dhe për të qenë përtej praktikave tradicionale dhe praktikave që mbajnë barriera. Diskutimet, detyrat dhe aktivitete në këtë kurs do t'i përgatisin studentët me njohuri dhe vizion praktik për preventivat dhe mënyrat e intervenimit në familje dhe shkollë. Në fund të kursit, çdo student duhet të ketë të hartuar dhe të dorëzojë një plan, për mënyrën e intervenimit në një rast të caktuar në familje ose shkollë.</p>
19	<p><b>Edukimi për qytetari demokratike</b></p> <p>Edukimi për qytetari demokratike, është një dimension i edukimit shumë aktual dhe mbase i nevojshëm për familjen, shkollën dhe shoqërinë në përgjithësi. Qëllimi i këtij kursi, është që studentët master t'i thellojnë njohuritë për edukimin për qytetari demokratike, për përkufizimet, përmbajtjet, detyrat, strukturën dhe rëndësinë e kësaj fushe. Do të studiojnë edhe për konceptin e edukimit për qytetari dhe të edukimit për demokraci, për edukimin për të drejtat e njeriut, për edukimin civil, edukimin për paqe, për edukimin global, për multikulturalizmin dhe qytetarinë aktive në shkallë globale, përkatësisht për një shoqëri moderne dhe demokratike. Kursi, <i>Edukimi për qytetari demokratike</i>, u mundëson studentëve master të thellohen për fushat ndërkulikulare a kroskurrikulare, si: edukimi për qytetari demokratike, kultura e komunikimit, edukimi për atdhedashuri, integrimi në Evropë dhe në botë, shëndeti mendor e fizik, edukimi në karrierë, edukimi ekologjik, etj. Do të debatojnë edhe për përvojat dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe vendore të edukimit për qytetari demokratike, për përcaktimet dhe objektivat, kompetencat për qytetari demokratike, metodat, qendrat e qytetarisë, politikat arsimore, sistemet për mbështetjen e edukimit për qytetari demokratike.</p>
20	<p><b>Trajtimi pedagogjik i sjelljes së papërshtatshme në shkollë</b></p> <p>Duke pasur parasysh problemet në shkollë, dhuna e shprehur, sjelljet e papërshtatshme, në këtë kurs ofrohen tema që trajtojnë sjelljen e papërshtatshme të nxënësve në shkollë dhe në klasë. Kursi ofron njohuri, përkitazi me sjelljen e papërshtatshme të nxënësve, teoritë mbi çrregullimet emocionale dhe të sjelljes: teoria biofizike, teoria psikodinamike, teoria biheviariste, teoria sociologjike, teoria ekologjike dhe teoria e konfrontimeve/qasjeve të ndryshme. Pjesa tjetër e kursit, i kushtohet teorive psiko-pedagogjike, përkitazi me reduktimin e sjelljes së papërshtatshme në klasë si: injorimi i sjelljes së papërshtatshme apo mësimdhënia demokratike, teoria skineriane, terapi realiste, disiplina assertive, vetkontrolli i sjelljes, disiplina me dinjitet dhe modele apo teori të tjera. Temat e ofruara japin mundësi për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive, për të trajtuar sjelljen e papërshtatshme në shkollë dhe në klasë, qoftë në punën si mësimdhënës apo pedagog i shkollës.</p>
21	<p><b>Teza e masterit</b></p> <p>Sipas udhëzuesit për hartimin e Tezës së Masterit- FEdu.</p>